# DËSHMI ARKIVI

**A-435722**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Funerali shtetëror për Mladiçin, Marta Kos: Serbia duhet të përballet me të kaluarën! Raporti i shtatorit do të peshojë të ardhmen e saj europiane |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/funerali-shteteror-per-mladicin-marta-kos-serbia-duhet-te-perballet-me-te-k-i585274` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 10 shtator 2026, 19:24:27 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 10 shtator 2026, 20:05:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `6062fbf1724b9fe23b0ebc3c4e98e6d05db0e88f3a8ec2a554635b8f92d10840` |
| TEKSTI | `7bd83d20c8273a3eecee21704a9d29f74525c60909563a4e222eaf2f3772055c` |
| PAMJA | `c6ebd1bffe5e2bc987d8d9efc3157dd5e53228254e8694b3b0c5f6b30d1435d9` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `0bda56af891579c48ff172e9654a5fadf48fe2be6d7f5c564a94ec80a2c1f4cd` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `542a3a3db8837abd67a91c70b58dc4a8c438063f1e082ebd959a0e7f73c23349` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/0bda56af891579c48ff172e9654a5fadf48fe2be6d7f5c564a94ec80a2c1f4cd`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Funerali shtetëror për Mladiçin, Marta Kos: Serbia duhet të përballet me të kaluarën! Raporti i shtatorit do të peshojë të ardhmen e saj europiane

10 Shtator 2026, 22:05Bota TEMA

Funerali shtetëror për Mladiçin, Marta Kos: Serbia duhet

Komisionerja Europiane për Zgjerimin, Marta Kos, ka reaguar pas funeralit shtetëror të Ratko Mladiç, i dënuar për gjenocid dhe krime lufte në Bosnjë e Hercegovinë, i mbajtur në Beograd.

Ajo tha se Bashkimi Europian duhet të vendosë nëse Serbia është ende një vend i përshtatshëm për t'u pranuar si kandidate për anëtarësim në BE.

Ajo shtoi se Serbia ndodhet në një udhëkryq, pasi procesi i pranimit kërkon përballje me të kaluarën, pajtim të vërtetë dhe respektim të sundimit të ligjit. Ajo paralajmëroi se raporti mbi gatishmërinë e Unionit për anëtarë të rinj do të përfundojë deri në fund të shtatorit dhe do të shërbejë si bazë për diskutim në Këshillin e BE-së në tetor.

Komisionerja theksoi se është e gatshme të bëjë gjithçka për ta mbajtur Serbinë në rrugën europiane, por kjo varet edhe nga popullsia dhe zgjedhjet e ardhshme në vend.

Ajo anuloi vizitën në Beograd për shkak të funeralit të Mladiçit, duke thënë se nuk mund të shikonte më në sy nënat e Srebrenicës nëse do të merrte pjesë në një situatë ku lavdërohej një kriminel lufte.

Kos nënvizoi se përballja me të kaluarën është një nga sfidat më të mëdha të Ballkanit Perëndimor dhe se elitat politike duhet të shërojnë plagët e së kaluarës, jo t'i thellojnë ato.

Duke folur për zgjerimin e BE-së, ajo tha se Unionit i është dashur të braktisë qasjen "gjithçka ose asgjë" dhe të zbatojë integrimin gradual, duke ofruar përfitime të pjesshme për vendet kandidate në sektorë strategjikë si energjia, transporti dhe lëndët e para kritike.

Kos përmendi shembullin e Moldavisë dhe Ukrainës, të cilat po ndihmohen të bëhen të pavarura energjetikisht nga Rusia deri në vitin 2027.

Ajo shtoi se BE-ja duhet të nxjerrë mësime nga bllokimi i vendimmarrjes nga Hungaria dhe të përfshijë klauzola mbrojtëse në traktatet e ardhshme të pranimit, për të garantuar respektimin e rregullave dhe vlerave.

Një dokument mbi ndikimin e zgjerimit pritet të prezantohet në fund të shtatorit, ndërsa zgjedhjet e ardhshme në Europë do të ndikojnë drejtpërdrejt në vendimet për zgjerimin.

Kos paralajmëroi se suksesi i euroskeptikëve mund ta vështirësojë procesin, por një Evropë më e fortë do të thotë mbrojtje më e mirë e interesave të qytetarëve dhe një mundësi për të reflektuar mbi vetë Unionin.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Sulm me thikë në Londër, katër persona plagosen në një përleshje në rrugë

20:55 Bota / 2 komente

Bie zjarr në një anije në Kinë, 20 viktima

20:35 Bota

Presidenti i Mongolisë habit ushtarët! 58-vjeçari ngre 100 kg peshë, pamjet bëhen virale

19:55 Bota / 4 komente

Arrestohen spiunët e Iranit/ Londër, një burrë dhe një grua punonin për shërbimin sekret iranian

19:35 Bota / 1 koment

Trump premtoi 5 mijë dollarë për çdo amerikan nëse republikanët fitojnë zgjedhjet, por sa i ligjshëm është shpërblimi?

18:35 Bota / 2 komente

Skandal me "Call-Centerat" në Ukrainë, DW: Të përfshirë zyrtarë të Prokurorisë!

16:55 Bota

Reforma brenda BE: Plani franko gjerman drejt miratimit, plani që favorizon Shqipërinë

16:45 Bota / 2 komente

Algjeria ndërpret marrëdhëniet diplomatike me Emiratet e Bashkuara Arabe

16:15 Bota

Turqia dhe 7-të vende të tjera mbështesin sanksionet britanike ndaj vendbanimeve izraelite në Bregun Perëndimor

16:05 Bota

Gjermania gati planin, synon të fusë Inteligjencën Artificiale në operacionet ushtarake

15:35 Bota / 1 koment

**Më të lexuarat**

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**“Berisha gënjeu demokratët” - Bejko: Nuk ka më të drejtën...**

09:45 Politika / 16 komente

**VIDEO/ Protestuesit nuk kursejnë as qytetarët, sulmojnë n...**

21:12 Politika / 80 komente

**Plas në PD, Çim Peka sulmon Belind Këlliçin: Ky idioti po...**

15:45 Politika / 18 komente

**Gjyqtarët kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, reago...**

13:04 Politika / 49 komente

**Përçarja në protestë, Balla i përshëndet nga Paskuqani pa...**

22:10 Politika / 3 komente

## Blog Tema

**Një telash më shumë për Partinë Demokratike**

19:10 Blog / 4 komente

**Kur protesta nuk shqetëson pushtetin, por merr peng qytetarin**

18:28 Blog / 12 komente

**Sikur Lana të mbyste bulevardin me baltë**

17:05 Blog / 6 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by



Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.